



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA  
PREKRŠAJE U PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 37309/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Kamoran Goranci nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollimin e Pasurisë së zyrtarëve të Lart Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1. 1 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 09.12.2011 merrë këtë:

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Komoran Esat Goranci nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollimin e Pasurisë së zyrtarëve të Lart Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar.

Pezullimi behet konforme neni 198 al.1 të LMK-es se fjalë për veprim që nuk është përcaktuar si kundërvajtje. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr.01-4114/11 të dt 26.10.2011 për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurit e për kundërvajtjen e lartëcekur.

Ne baze të kërkesës u dëgjua deklarata e të lartëcekurit i cili deklaroi se e kam parë postin e ushtruesit të detyrës të departamentit të kulturës të kësaj Ministrie dhe unë nuk e kam deklaruar këtë pasuri se si ushtruesi i detyrës jam i obliguar që të paraqes këtë pasuri dhe me zgjedhjen e time në këtë postë unë me dt. 02.11.2011 e kam derzuar formularin, për deklarimin e pasurisë pranë këtij Agjensionit.

Për vërtetimin e gjendjes faktike u dëgjuar parashtruesi i kërkesës Afrim Atashi i cili në deklaroi qëndroj pranë kërkesës të cilën e kemi parashtruar, por nuk ka paragraf që përcakton përgjegjësin e ushtruesit të detyrës dhe sipas kësaj personi nuk ka përgjegjësi për ta paraqitur deklarimin e pasurisë.

Sipas kërkesës së ushtruar marrjes në pyetje të pandehurit dhe prova të tjera të administruar në lëndë, gjyqtari, konform 3-tij me përkufizimin zyrtarëve të lartë publik nuk ishte e parapara kategori e ushtrueseve të detyrës që të njëjtit të obliguar ta paraqesin pasurinë e tyre të parapara sipas këtij Ligji, andaj konform neni 198 al.1 të LMK-së e PEZULLOI procedurën kundërvajtëse ndaj të lartëpërmendurit, se fjalë për veprim që nuk është përcaktuar si kundërvajtje.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të ushtroj pala dhe ushtruesi i kërkesës Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate pa taksë.

Gjyqtari për Kundërvajtje  
Fatmir Behrami

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. D-P	Br. Prot.
Dep.	Prot. No. 03-5150/11
Nr. faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date 30.12.2011
PRISHTINE	